



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2806 / 16 prot.

Pogradec, më 29 . 07 2025

VENDIM
Nr. 73 , DATË 28 / 07 /2025

PER MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QIRA, NË FAVOR TE INDIVIDEVE KËRKUES PËR KRYERJEN E OPERACIONEVE TË KËRKIM-ZBULIMIT HIDROKARBURE, GJEOLGJIKE E MINERARE, UJI, VENDOSJE OBJEKTESH TË NDRYSHME NDIHMËSE NË SIPËRFAQE, TË PASURISË ME SIPËRFAQE TOTALE 40000 M2 (DYZET MIJË) M2.

1. Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.816, datë 04.06.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore pyje e kullota në Komunën Çërravë, të Qarkut të Korçës", i ndryshuar me VKM nr. 398, datë 19/05/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Keshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronesi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave /Bashkive", si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave, Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien në shfrytëzim/perdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtarive ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

2. Të miratojë në parim dhënien me qira, për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, për pasurinë e ndodhur në fshatin Blacë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Pasuria	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kërkeses
1	1208	34/1	Blacë, Çërravë	40000	Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje

[Signature]

					objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe
--	--	--	--	--	---

3. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje, sipas periudhes te percaktuar ne projektin teknik, të hartuar nga kërkuesit në konkurim.
4. Ne referim te baze ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore "
5. Tarifat për dhënien me qera të kesaj pasuri, të aplikohen sipas pikes "9", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.
6. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Pogradec për ndjekjen e procedurave ligjore dhe për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 18 **vota**

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 1

5.Zbardhur më date 28.07.2025